



FINANCA PËR VENDIMMARRËSIT

Audienca:	Drejtues ose punonjës kyç. (Drejtues në Shitje, Prodhim, Blerje, Marketing, Burime Njerëzore, Prokurime, Projekte, Mirëmbajtje, IT, etj.)
Datat:	15 & 16 Nëntor 2018.
Kohëzgjatja:	2 ditë, ditën e Enjte dhe ditën e Premte.
Orari:	Fillon në orën 9:30 deri 17:00.
Numri i pjesëmarrësve:	Min 12 - Max 16.
Vendi:	Hotel Garden, http://hotelgarden-ks.com .
Pushimi i drekës:	Një orë, rreth orës 12:30-13:30.
Pushimet e kafesë:	Dy pushimet do të zhvillohen rreth orës 10:00 dhe orës 15:00.
Gjuha:	Shqip.
Telefonat celulare:	Telefonat celularë duhet të jenë të mbyllur ose të heshtur gjatë trajnimit.
Trajnues:	Erald Pashaj

Prezantimi i trajnimit:

"Në ditët e sotme është domosdoshmëri për çdo menaxher dhe person kyç në çdo organizatë, për të kuptuar dhe njohur shifrat e biznesit të tyre, si edhe kontrolluar të ardhurat dhe shpenzimet"

Kursi Financa për Vendimmarrësit (*Finance for Decision Makers*) është një nga trajnimet më të dobishme dhe *premium* për menaxherët në mbarë botën. Sot askush nuk mund të jetë një menaxher i suksesshëm nëse nuk është financiarisht i përgatitur dhe nëse nuk kupton aspektet financiare të biznesit. Njohuritë financiare mund t'ju duken të vështira dhe raportet të paqarta. Por, a është vërtetë kaq e vështirë? Nëpërmjet këtij kursi ju do të mësoni të përdorni gjuhën që përdorin njerëzit e financave, duke e bërë komunikimin më të lehtë, minimizuar rrezikun dhe kapur mundësitë.

Për më tepër, duke përdorur njohuritë e fituara në këtë trajnimi, ju do të jeni në gjendje të lexoni dhe kuptoni raportet financiare, t'i lidhni ato me biznesin tuaj të përditshëm dhe të merrni vendime më të mira. Ky trajnim nuk është vetëm për financierë, përkundrazi ky trajnim është për drejtues jo-financierë dhe punonjës kyç, të cilët me vendimet e tyre ndikojnë në performancën financiare të ndërmarrjes.

Rreth trajnimit.

Ky trajnim ju siguron aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të marrë një vendim. Programi është shumë interaktiv dhe shpjegon terminologjinë e financave, dokumentet kryesore financiare, organizimin e financave dhe konceptet kyçe financiare si të ardhurat dhe kostot, matjen e fitimit, përfitimin neto, etj. Teoria është e kombinuar me shembuj praktikë, video dhe ushtrime.

Ky trajnim do të zhvillohet pa PC ose aplikacione të tjera.

Si do të ju ndihmojë ky kurs?

Ky kurs do të rrisë njohuritë tuaja financiare dhe do t'ju njohë me mënyrën se si shifrat mbështesin punën tuaj të përditshme dhe sesi nëpërmjet tyre ju mund të monitoroni biznesin dhe të merrni vendime shumë më të mira.

Temat që do trajtohen:**Dita e 1^{-rë}**

1. Hyrje;
2. Bazat e terminologjisë financiare;
3. Departamenti i financës dhe ndërveprimi me departamentet e tjerë;
4. Raportet kryesore financiare; (Pasqyra e të Ardhurave & Shpenzimeve, Bilanci, Fluksi Monetar.)
5. Kontrolli i brendshëm;

Dita e 2^{-të}

1. Përsëritje;
2. Përfitueshmëria nga klientët; (A janë të gjithë klientët fitimprurës?)
3. Planifikimi financiar; (Buxhetimi)
4. Kontrolli analitik; (Për çdo departament)
5. Investimet. (Kthimi nga investimi: Koha dhe mënyrat e kthimit, etj.)

Investimi:

- Na kontaktoni: info@eppc.al / kosovo@eppc.al

Të përfshira:

- Të gjitha materialet didaktike gjatë trajnimit;
- Libërlidhjet;
- Mjetet personale të punës;
- Organizimi. (Salla, drekat, pushimet e kafesë, etj.)

Konfirmimi:

Ju lutem të na konfirmoni № e punonjësve që dëshironi të dërgoni në këtë trajnim?

[1. Emër - Mbiemër; 2. Pozicioni; 3. Vite/muaj pune.]

